

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Vendimi ndaj ish-krerëve të UÇK-së kalon në fazën e Apelit – cilat pjesë mund të rishikohen?
ADRESA	https://albeu.com/kosove/vendimi-ndaj-ish-krereve-te-uck-se-kalon-ne-fazen-e-apelit-cilat-pjese-mund-te-rishikohen/1018814/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHÀ


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 14:19:59 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 14:17:10 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	16a780e8606e64c0ed3d4ee6aef87657b20bb3aa889e2feb9ff4df0064bb6eef
TEKSTI	da5d1603d4fa2d2cbf0388fe2199543553b029422f825635f1619ef506649d8c
PAMJA	201e3805b60eda404bc5c17702df8520deedc247f02659c657844f9c528dcdb3

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4e95d3c7a0ab291ca43fe5ff3db93f9a299e9625fa7ba7a99e27c64786efeaba
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	46a7af3000d16e9ffefcbfa0ca0d8af83c85fda72b67353c14db1e839b49f770
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4e95d3c7a0ab291ca43fe5ff3db93f9a299e9625fa7ba7a99e27c64786efeaba>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Vendimi ndaj ish-krerëve të UÇK-së kalon në fazën e Apelit – cilat pjesë mund të rishikohen?



Gjykata Speciale në Hagë, më 16 shtator, i shpalli fajtorë ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Rexhep Selimin dhe Jakup Krasniqin, për katër akuza për krime lufte. Dënimet e shqiptuara ndaj tyre arrijnë në total 81 vjet burgim.

Shpallja e vendimit në shkallën e parë, megjithatë, nuk shënon përfundimin e përbaljes ligjore.

Fokusi tani pritet të zhvendoset te procedura para Panelit të Apelit. Mbrojtja mund ta kundërshtojë aktgjykimin dhe të kërkojë që pjesë të tij të ndryshohen ose të anulohen, ndërsa një nga çështjet kryesore është hapësira që ka Apeli për të ndërhyrë në përfundimet dhe dënimet e vendosura nga shkalla e parë.

Sipas ekspertëve të fushës juridike, ankesa mund të çojë në rishikimin e disa konstatimeve të aktgjykimin ose të masave të dënimit. Rezultati do të varet nga çështjet dhe argumentet që palët do t'ia paraqesin Panelit të Apelit.

E drejta për të ushtruar ankesë nuk i takon vetëm mbrojtjes. Edhe Prokuroria mund të kundërshtojë pjesë të vendimit, përfshirë pikat liruese, si dhe çështjet që kanë të bëjnë me llojin dhe lartësinë e dënimeve.

Avokati Gazmend Halilaj, duke folur për "Bota sot", ka shpjeguar se pas aktgjykimin të Gjykatës Speciale në Hagë, vëmendja duhet të përqendrohet te procedura e Apelit dhe mundësia për ndryshimin e vendimit të shkallës së parë.

Ai ka theksuar se ligji ia njeh mbrojtjes të drejtën për ta kundërshtuar aktgjykimin dhe për të kërkuar ndryshimin ose anulimin e atyre pjesëve që i konsideron të pabazuara apo në kundërshtim me ligjin.

të fundit /



Vendimi ndaj ish-krerëve të UÇK-së kalon në fazën e Apelit...



Mourinho për ecurinë mbresëlënëse të Barcelonës: "Real..."



Për të dalë nga "kriza" duhet vetëm fitorja, starton Vora...



Jashari kërkon pranimin e Kosovës me të drejta të plota në Kartën e...



Buffon rikthehet në shkollë në moshën 48-vjeçare, pasi fitoi Kup...



Feronikeli '74 dhe Vushtrria synojnë rikthimin te rezultatet...



Koci kërkon shpjegime publike nga ekipet mbrojtëse të krerëve ...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Sipas Halilajt, në Apel mund të trajtohen mënyra e zbatimit të ligjit, vlerësimi i provave dhe zhvillimi i procedurës gjyqësore. Për këtë arsye, dënimet mund të ulen ose të ndryshohen pjesërisht, ndërsa në rrethana të caktuara mund të rishikohen edhe disa përfundime të shkallës së parë. Ai ka sqaruar se asnjë prej këtyre mundësive nuk është e garantuar, pasi vendimi përfundimtar merret nga Paneli i Apelit në bazë të argumenteve të paraqitura gjatë procesit.

Halilaj ka kërkuar gjithashtu që çështja të trajtohet vetëm në rrafshin juridik dhe institucional, pa paragjykim dhe pa ndikim politik. Ai ka deklaruar se e mbështet Gjykatën Speciale dhe se vendimet e saj duhen respektuar si pjesë e një procesi gjyqësor, por njëkohësisht duhet të garantohet edhe e drejta e të akuzuarve për ankesë dhe për proces të rregullt.

Sipas tij, duhet pritur shqyrtimi në Apel për të kuptuar se cilat pjesë të aktgjykimit do të mbeten në fuqi, cilat mund të pësojnë ndryshime dhe cili do të jetë përfundimisht vendimi ndaj katër ish-pjesëtarëve të UÇK-së.

Avokati ka nënvizuar se edhe Prokuroria mund të ankohet kundër pikave ku janë dhënë vendime liruese, duke kërkuar ndryshimin e tyre dhe shpalljen fajtorë të të akuzuarve.

Ai ka shtuar se ankesë mund të parashtrohet edhe për pikat ku të akuzuarit janë shpallur fajtorë, konkretisht lidhur me llojin dhe masën e dënimit. Për rrjedhojë, sipas Halilajt, Gjykata e Apelit mund ta ndryshojë vendimin edhe në dëm të të akuzuarve.



Ndërkaq, juristi Blerim Burjani ka deklaruar për "Bota sot" se rezultati i procedurës së ankesës do të kushtëzohet në masë të madhe nga niveli i përgatitjes dhe puna e mbrojtjes. Ai ka thënë se në këtë fazë ende nuk mund të përcaktohet se në çfarë mase mund të ndryshojnë dënimet.

Burjani ka vlerësuar se mbrojtja duhet të angazhohet më shumë për sigurimin e fakteve që mund të ndikojnë në ndryshimin e verdiktit gjyqësor. Sipas tij, ulja e dënimit do të ndodhë, por përmasa e saj nuk mund të dihet pa nisur dhe pa u zhvilluar procesi i ankesës. Ai ka shtuar se nevojitet shumë punë për të gjetur fakte të konsiderueshme që do të mundësonin lirimin e çlirimtarëve.

Duke e përshkruar situatën si shumë serioze, Burjani ka kërkuar edhe përfshirjen e shtetit në mbështetje të mbrojtjes. Sipas tij, shteti duhet të ofrojë përkrahje përmes ekipeve profesionale, me synim arritjen e lirisht.



Pas vendimit në Hagë, Hamza shkon për vizitë te familjet Thaçi, Veseli dhe...



Jashari kërkon pranimin e Kosovës me të drejta të plota në Kartën e Adriatikut



Koci kërkon shpjegime publike nga ekipet mbrojtëse të krerëve të...



FSK-ja dhe Policia e Kosovës zhvillojnë ushtrimin "VALOR SHIEL...



Haxhiu: Tri familje mësojnë fatin e të afërmeve të zhdukur që nga viti 1999



Tahiri ndan fotografinë me Rugovën dhe Thaçin: Edhe sot kemi nevojë për unitet



Sveçla: Zbardhja e fatit të personave të zhdukur, përparësi e shtetit



Kurti njofton identifikimin e tri viktimave nga "Grupi i Intelektualëve



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë